**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**
**Këshilli i Ministrave**

# V E N D I M

**Nr.575, datë 10.08.2011**

## PËR

## MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 106 pika 2 (i) dhe nenit 107 të Ligjit 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave,

## V E N D O S I

1. Miratimin e "Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Programi Kombëtar i Sigurisë së Aviacionit Civil dhe çdo kopje e tij është pronë e Autoritetit të Aviacionit Civil dhe duhet të kthehet kur nuk është në përdorim.
3. Vendimi Nr .91, datë 20.2.2004 " Për Miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", shfuqizohet.
4. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë dhe botohet ne fletoren zyrtare

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**